



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 184/ 2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur, përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë procesit të zgjedhjeve në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 21.06. 2012, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 18.06.2012, nga subjekti politik LVV, dega në Kaçanik, me të cilën pretendohet se me datën 17.06.2012 në Qendrën e Votimit (QV) 0706D/02R, dy persona vëllezër me emrat Fadil Nazmi Guri dhe Faruk Nazmi Guri, kanë hyrë në Vendvotim (VV) duke mos e respektuar rendin me përdorimin e dhunës. Të njëjtit, sipas parashtruesit të ankesës kanë fyer anëtarin e LVV-së Veton Guri me fjalët “ti je pis”. Parashtruesi i ankesës thekson se Fadil Nazmi Guri është punëtor i komunës, ndërsa Faruk Guri pas votimit të tij ka ekspozuar votën e tij dhe ka thënë “ja për kanë kam votuar për PDK-në”

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 18.06.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik nga ana e LVV-së dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 19.06.2012, në ora 15:00.

PZAP-i, me datën 19.06.2012, mori përgjigjen e kërkuar nga PDK lidhur me ankesën e paraqitur nga LVV-ja, në të cilën theksohet se lidhur me rastin në VV 0706D/02 ka ndodhur një zënkë verbale në mes Emin Miftarit përfaqësues i AAK-së dhe votuesit Fadil Guri, ku votuesi është acaruar duke fyer kryesuesin e vendvotimit Jeton Tifekun nga mllefi. Kryesuesi i vendvotimit ka dashur ta qetësoj situatën dhe është fyer nga të dy palët. Kryesuesi nuk ka ndërmarr asnjë veprim tjetër.

Me datën 18.06.2012, PZAP-i kërkoj nga Policia e Kosovës që të ndërmarr masa hetimore për rastin në fjalë.

Në raportin e policisë të datës 19.06.2012 me nr. 2011-CE, theksohet se në fshatin Dubravë të Kaçanikut në shkollën fillore "Kadri Zeka" në QV 0706D, gjatë gjithë kohës sa kanë qëndruar në këtë pikë çdo gjë ka qenë në rregull dhe nuk është raportuar ndonjë parregullsi apo për diçka të tillë.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

Ankesa është e pabazuar.

PZAP-i gjeti se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë pasi që nuk ka prova të asaj natyre për ti vërtetuar pretendimet ankimore, kjo vërtetohet edhe përmes raportit të policisë me nr. 2011-CE të datës 19.06.2012, në të cilën theksohet se gjatë kohës sa kanë qëndruar pjesëtarët e policisë së Kosovës në vendin e ngjarjes nuk është raportuar dhe nuk ka pasur ndonjë parregullsi, andaj PZAP-i pretendimet e tilla ankimore i vlerësoi si të pabazuara dhe të pa argumentuar në prova dhe dëshmi bindëse, andaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 184/2012 më datën 21.06.2012.

**Kryesuesi i panelit
Ymer Hoxha**

